

## **RELACION**

Restaurimi i catise dhe fasades banesa Angonate



*Konceptoi relacionin: Ing. Ardis Duka*

*Ing. Vasil Polo*

*Ark. Rodhalia Dhima*



## 1. Vendodhja

Banesa e Angonateve ndodhet ne lagjen Palorto te qytetit te Gjirokastres me koordinata gjeografike Latitude  $40^{\circ}4'25,27''$  N dhe Longitude  $20^{\circ}8'12,12''$  E. Eshte shpallur Monument Kulture e Kategorise se pare me nr vendimi/ date 1886-10/06/1973. Ajo ndodhet ne nje nga pikat me te dukshme dhe te vizituveshme te qytetit te Gjirokastres.



Banesa e Angonateve

Fig 1. Ortofoto




Fig 2. Objekti ne harte



## 2. Historia e banesës “Angonate”

Kjo është shtëpia më e madhe tradicionale në Gjirokastër, e vendosur dhe në vendin më të dukshëm. Është gjithashtu shtëpia më e fotografuar nga turiste vendas dhe huaj, te cilet vizitojnë Gjirokastren. Për shkak të pozicionit, madhësisë, bukurisë ajo ndodhet në gjithë kartolinat që prezantojnë Gjirokastrën. Shtëpia u ndërtua në 1881 nga dy vëllezërit Hanko. Ata luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e qytetit, dhe për këtë arsyе Ismail Kadare i ka kushtuar një libër të posacëm në 1977 të titulluar Breznitë e Hankonatëve, një libër për sagën e tyre. Në fakt nuk është shtëpi e thjeshtë, por një kompleks me dy shtëpi dhe dy kopshte. Kjo shtëpi pasqyron ndryshimin e arkitekturës së shtëpive në fund të shekullit të 19-të, duke qenë se ka disa elementë të shtuar si ballkoni dhe çatia e mansardës në pjesën qendrore, simbole të ndikimeve të reja në ndërtimin e shtëpive në atë kohë.

Banesa është e ndërtuar me mure guri shtresor. Ky kompleks është ndër shembujt më të mirë për të treguar zhvillimin e banesës gjirokastrite dhe aftësinë e saj për t'iu përshtatur kushteve të jetesës. Ndryshtet si ‘Kështjella e Kështjellarëve’. Kompleksi i Angonatëve ka dy porta me një zakon. Nga kjo hynin të lindurit kurse nga pjesa e prapme dilnin ata që ndërronin jetë.




Fig 3. Fasada origjinale e banesës






Fig 4. Marre nga nje pllake guri ne hyrje te shtepise, dera kryesore




Fig 4. Rilevime nga arkivi te vitit 1979



### **3. Përshkrimi Arkitektonik**

Përsa i përket skemës funksionale, banesa ruan mirë atë tradicionalen, kështu të dy njësitë që formojnë kompozimin, të kujtojnë variantin me një krah të zhvilluar. Banesës nuk i mungon stera, e cila ka dy marje për secilën familje, qilari i zahiresë dhe ambientet e gatimit. Trajtimi i ambienteve të tjera ruan mjaft nga karakteri i shembujeve më të vjetër, por aty shihet se kompleksi musandër-dhipato fillon të humbasë punimin dhe trajtimin fillestar. Me rëndësi është të vërejmë se banesa nuk ka cardak dhe asaj i mungon katoi. Dritaret e shumta dhe të mëdha, që në katin përdhe gjithashtu tregojnë shumë për dobësimin e tipareve mbrojtëse dhe thellimin e natyrës qytetare të saj. Element unikal duhet konsideruar ballkoni në katin e dytë, ndërsa mjaft e rrallë një lloj mansarde, që ngritet në pjesën qëndrore mbi cati. Kompozimi i cili është simetrik në disa pjesë të vecanta, ka zhvillime jo paralele, kryesish për shkak të terrenit. Ky kompleks banimi, është një shembull shumë kuptimplotë për të treguar zhvillimin e banesës gjirokastrite dhe aftësinë e saj për t'iu përshtatur kushteve të jetës në zhvillim.

Përpara banesës është ngritur një ndërtim dy katësh (zapanaja), mjaft i shtrirë dhe trajtuar me erker në katin e sipërm, i cili lidhet shumë mirë me vetë banesën. Ky ndërtim, kryen funksionin e odajashtës dhe pjesërisht del në oborrin qëndror, anash të cilit janë dy oborre më të vegjël. Pra kompleksi ka tre oborre, rrast ky mjaft i rrallë, që është diktuar nga arsyja e përmendur më sipër.

### **4. Përshkrimi Konstruktiv**

Muret e jashtme në këtë banesë masive janë të ndërtuara me mur guri me llaç gelqere. Kati i sipërm në fasadë është e realizuar me çatma dhe karkteristikë e kësaj banese është ballkoni. Çatia është e realizuar me konstruksion druri dhe e mbuluar me rasë guri. Dyshemetë janë të realizuara me dru.

- Ne vitin 2008 eshte realizuar restaurimi i plete i banesës.

### **5. Problematikat e shfaqura dhe gjendja ekzistuese**

Banesa ne ditet e sotme eshte e pabanuar pasi gjendja e saj paraqitet jo e mire. Vetem kati i dyte I banesës eshte i banuar dhe ne gjendje te mire konstruktive





*Fig 5dhe 6 . Hapesira e hamamit dhe dy oxhage brenda saj*

DRTK Gjirokaster, pas inpektimit ne banese vuri re disa problematika te cilat duhen shqyrtuar per te shmhangu rrezikshmerine e metjeshme te baneses. Fasada ballore, ajo me e dukshme e cila perfaqeson banesen, paraqet probleme kryesish me lageshtine ne murature, elemente drusor te kalbur ne dritare, dhe kryesish suva te demtuara, si dhe pranine e bimesise se larte dhe te ulet. Gerryerje dhe degradim i muratures dhe struktures gelqerore si pasoje e agjenteve te jashtem.

Prania e vegjetacionit ,barerave te keqia dhe bimesise kacavjerrese perben nje problem madhor. Pasi te jete konstatuar lloji i bimesise per te parashikuar thellsine e rrrenjeve, heqja mekanike e tyre mund te behet me mjete si gershore dhe sharre ose perdorimin e dezifikanteve te lengshem.





Fig 7 . Prania e bimesise ne hyrje te banesës




Fig 8. Prania e bimesise se dendur nag ana e fasades veriore





*Fig 9. Prania e bimesise kacavjerrese ne fasade*


- **Restaurimi I fasades**


Duke qene se objekti Angonatet eshte embleme e pazarit te Gjirokastres dhe eshte me I fotografuari, ne projekt mendojme te restaurojme fasaden ballore e cila eshte me kryesorja dhe me dukshmja nga pamja vizuale e saj. Ne projekt eshte menduar prishja e suvatimit te jashtem te catmase e cila sic shihet dhe ne foto eshte e care dhe pjesa – pjesa ka rene.

Punimet konsistonje heqjene suvase, Nderrimin e ndonje elementi te catmase dhe pastrimin e konstruksionit te tij per tu ngjitur llac horasan. Llaci horasan do te trazohet me lesh dhie te prere I cili do sherbeje edhe si armature e llacit per tu lidhur me mire me konstruksionin e catmase. Duhet patur kujdes gjate zbatimit te punime qe dora e pare e suvase te lidhet sa me mire me konstruksionin e tij duke future brenda elementeve llacin, per tu lidhur dhe mos u shkeputur nga konstruksioni I drurit. Ne qofte do duket e arsyeshme, ne pjesa delicate te tij mund te perdoret edhe rjete metalike ose plastike. Por qe do jete e padukshme.



*Fig 10. Fasada ballore*





Carje ne murature

Demtim I suvase

*Fig 11. Fasada ballore*

- **Restaurimi i catise**

Banesa e Angonateve ka shumë probleme që duhen riparuar. Së pari janë çatia dhe një pjesë e murit jugor. Do te behet restaurimi i çatisë pasi do të zbulohet nga rasat e gurit, do të kontrollohen të gjitha nyjet lidhese, mahite, petavrat traret etj. Do t'i kushtohet shume rendesi dhe kujdes perzgjedhja e elementeve qe do te zevendesohen me te reja. Materiali që do të përdoret do të jetë dru pishe ose bresh i maturuar. Do të ketë perfocim të nyjeve të dëmtuara pa i zëvendësuar ato me të reja, aty ku duhet. Procesi i restaurimit duhet të bëhet kur nuk ka reshje shiu dhe moti është mjaft i mirë edhe pse specialistët duhet të marrin disa masa për të mbuluar çatinë në rast se do të bjerë shi. Rasa e gurit nuk duhet të jetë më e hollëse 2 – 2.5 cm. Eshte shume e nevojshme të ruhet materiali original. Puna restauruese do të kryhet kryesisht në strukturën e catmase se katit te dyte.

Nje pjese e catise do te restaurohet ndersa pjesa tjeter do te behet kthimi i catise duke nderuar nje pjese te rasave te gurit dhe ndonje petaver te deformuar.






Fig 12. Foto ajrore e catise se baneses me pjeset e demtuara.



Fig 13. Demtimet ne cati






Fig 14. Demtimet ne cati





*Fig 15. Demtimet ne cati*



*Fig 16. Demtimet ne cati*






Fig 17. Spreth qe ka nevoje per restaurim



## 6. Konkluzione

Objekti ka nevoje per nderhyrje dhe nga brenda por duke qene se objekti eshte prone private dhe pronaret mund te investojne vet, projekti ne fjale studion vetem fasaden e cila sic permendem edhe me larte eshte emblem pazarit karakteristik dhe shume e vizituar nga turistet e vendas dhe te huaj. Meqenese kjo banese tani per tani eshte e braktisur, mendojme se keto punime duhet te behen pasi pamja le nje shije te keqe te vizitoret.

**Konceptoi:**

**Ing. Ardis Duka**

**Ing. Vasil POLO**

**Ark. Rodhalia Dhima**

Vasil  
Polo

Digitally signed by Vasil  
Polo  
Date: 2024.08.31  
13:06:22 +02'00'

Sokol  
Ismaili

Digitally signed by  
Sokol Ismaili  
Date: 2024.10.22  
14:25:56 +02'00'

